

Jetmire Rexhepi, MA¹

UDC:

343.91-053.6:343.815(497.7)

**DELIKUENCA E TE MITURVE DHE TRAJTIMI PENAL NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

**МАЛОЛЕТНИЧКА ДЕЛИКУЕНЦИЈА И КРИВИЧНО
ПОСТАПУВАЊЕ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**

**DELINQUENCY OF MINORS AND CRIMINAL LAW
TREATMENT IN REPUBLIC OF MACEDONIA**

Abstract

Objectives and tasks of this scientific research has to do with treatment, analysis and synthesis of issues connected with phenomenon of criminality of minors delinquency. As the delinquency of minors is a phenomenon that constantly is growing, at this research we are going to treat the causes that determine minors delinquency as there are: Notion of minors delinquency and its criminal law treatment; Further follows the problem of minors delinquency for continuing with analysis and historic development of the criminal law for the minors, and the different outlooks about minors delinquency. To identify hitting tools, an ongoing is reflected the material and formal concept of minors delinquency, with what we clarify the law position of children and law responsibility of minors. At the end I am going to present inseparate part legal mater which regulates minors delinquency respectively the law for minors in RM.

So, in this research we are going to do the treatment for rights and obligations of the childrens, disrespect of those results with the phenomenon of their delinquency.

¹ Assistant part time in law faculty at the University of Tetovo, jetmirat@hotmail.com

Key words: Rights and obligations of childrens, rights and obligations of parents or mentors, minors delinquency, protection of minors, etc.

1. Nocioni i delikuencës së të miturve dhe trajtimi penal

1.1. Problematika e delikuencës së të miturve

Delikuenca e të miturve në të gjitha vendet e botës paraqet një problem shumë të rëndësishëm shoqëror. Në zgjidhjen e këtij problemi janë angazhuar fuqi të konsideruara individuale e shoqërore, madje edhe mjete financiare. Studimi dhe luftimi i delikuencës së të miturve në planin ndërkombëtar ka marrë aso përmasash dhe asi intensiteti sa që janë më të theksuara se në lëmit e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.²

Me emancipimin gradual të të miturve prej regjimit të përgjithshëm penal juridik i rezervuar për më të rriturit definohet edhe nocioni i delikuencës së të miturve, përmbajtja e të cilës do të thotë diçka tjetër, prej asaj që llogaritet krim i të rriturve. Ky nocion është hap përpara edhe në raportin e nocionit të krimit të të miturve i cili korrespondon me kuptimin për të miturit si kriminel të vegjël (në numër të vogël) nocioni i delikuencës së të miturve është bërthamë e sistemit kategorial të së drejtës penale për të mitur.³

Mituria (sipas ligjit të fundit – Fëmijëria) është ajo fazë e jetës së njeriut, në të cilën ai formohet dhe e cila përcjellët me një numër të madh dhe të llojllojshëm të ndryshimeve fiziologjike dhe psikologjike. Të miturit si pjesë përbërëse e shoqërisë paraqesin një botë relativisht të posaçme, me psikologji të posaçme, me mënyra të posaçme dhe reaksione të veçanta ndaj ngacmimeve të botës së jashtme.⁴

Ekzistojnë tre parime për përcaktimin e nocionit të delikuencës së të miturve. Sipas kuptimit më të ngushtë, ky nocion i përfshin vetëm sjelljet e përcaktuara me vepër penale. Ky kuptim, sipas të cilit nuk ka dallim mes veprave penale për të rritur dhe veprave për të mitur është dominues në më shumë legjislatura evropiane dhe po ashtu është i pranuar edhe në kodin e vjetër penal të Maqedonisë. Por sipas diksionit të nr. 71 të KPM - të vjetër) edhe “i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 14 vjet (fëmijë)” llogaritet si kryes i veprës penale edhe pse kundër tij nuk zbatohen sanksione penalo-

² L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, f.3.

³ K., Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, f. 594.

⁴ L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, f. 6.

juridike! Deri te nocioni më i gjerë ka sjellë evoluimi i së drejtës penale për të mitur në drejtim të vënies së idesë për edukim dhe përmirësim, nëpërmjet dominimit të masave edukuese. Ky nocion është zgjeruar edhe në bazë të sjelljeve që kanë karakter të shkeljes së dispozitave tjera: kundërvajtje, delikte civile, si dhe sjellje asociale dhe antisociale të cilët nuk janë të paraparë si vepra penale por ndikojnë në ngecjen e zhvillimit e të miturit ose duke e lenë më një anë dhe kërkojnë ndërmarrjen e masave të mbrojtjes dhe ndihmës (narkomanët, alkoolistët, lypësit, ikje prej shkolle etj.). Fillimi i ekspansionizmit të nocionit të delikuencës së të miturve është përcaktuar me ligjet e para mbi gjykatat për të miturit në SHBA (Ilinois 1899) kompetent për shqiptimin e masave të sigurisë dhe ndihmë jo vetëm për vepra penale por edhe sjellje asociale dhe antisociale ose lënien pas dore të sjelljes së të miturit (më gjerë, Kambovski, 7.388). Më vonë koncepti i gjykatave për të mitur me këtë kompetencë të zgjeruar është e pranuar edhe në disa legjislacione evropiane. Për nocionin më të gjerë të delikuencës së të miturve përcaktohet edhe pjesa më e madhe e literaturës kriminologjike, sipas së cilës ky nocion barazohet me sjellje devijuese, asociale ose antisociale të të miturve (Jasovic, 30, p.sh. për sjelljet kundërthënëse të të rinjve duke i përfshirë me këtë nocion lënien pas dore të sjelljes paaftësinë e shoqërisë dhe sjelljen e papranueshme të të rinjve). Nocioni më i gjerë i përfshinë edhe veprimet tjera dhe gjendjet që ndikojnë në lënien pas dore të zhvillimit ose edukatës dhe paaftësinë e të miturve ose me fjalë tjera gjendje të ndryshme paradelikte të personit! Për dallim prej të më parëve të implementuara në legjislaturën penale ky kuptim kryesisht është i njëjtë me rrafshin e qëndrimit teorik.

Koncepti klasik i të drejtës penale për të mitur edhe në KPM - të vjetër, është i bazuar mbi nocionin më të ngushtë si më i përafërt me parimin e ligjshmërisë. Por nga ana tjetër sot pranohet se ai mbetet në hijen e të drejtës penale për të rritur dhe se është nën ndikim e fortë të orientimit të tij represiv dhe retributiv. Gjithnjë më konkret është hapi në mes tezës për natyrën e veçantë të delikuencës së të miturve dhe nevojën për ndërmarrjen e masave komplekse preventive të edukimit, kujdesit dhe përmirësimit brenda dhe jashtë të drejtës penale dhe nga ana tjetër futjen e këtij nocioni në korniza të ngushta të drejtës penale! Në legjislaturat bashkëkohore në këtë kuptim është shprehur tendenca për krijim e bazës më të gjerë juridike për ndërmarrjen e masave të inspiruar me edukimin dhe mbrojtjen e të miturve për shkak të pengesës së sjelljes së tij antisociale ose sanimin e gjendjes edukuese së lënies

pas dore. Më pas si zgjidhje që siguron qasje integrative të preventivave të pastra dhe atyre penalo-juridike, format edukuese dhe ata të ngjashme të trajtimit, rekomandohet miratimi i ligjeve të posaçme për delikuent të mitur (në legjislacione ligjet e tilla janë paraqitur me emra të ndryshëm: për drejtësinë e të miturve, gjykata për të mitur etj.)⁵ Së fundi në këtë drejtim në Republikën e Maqedonisë në fuqi ka hyrë në ligji i ri që trajton delikuencën e të miturve dhe titullohet “Ligji për drejtësi për fëmijë i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë në datë 29.10.2013 dhe hyri në fuqi në ditën e 8-tetë nga dalja në gazetën zyrtare, kurse implementimi praktik i saj filloi nga data 01.12.2013, me ç’rast ligji i vjetër doli jashtë përdorimit në tërësi.⁶

Edhe sot, çdo shoqëri njerëzore e organizuar si shtet nëpërmjet institucioneve të ndryshme (familjes, shkollës, organeve të entit social, medimeve, etj.) ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale. Nuk ka dyshim se procesi i tillë i reagimit ndaj kriminalitetit është proces kompleks dhe i ndërlikuar, por i domosdoshëm. Megjithatë, nuk duhet pritur që procesi edukativ-preventiv, sado i rëndësishëm që është, të sjell deri te pengimi dhe zhdukja e plotë e kriminalitetit. Në këtë drejtim, është domosdoshmëri që shteti të angazhohet edhe në aspektin tjetër-në aspektin “represiv” të reagimit ndaj kriminalitetit.⁷

Rritja e delikuencës së të miturve në një shoqëri është e ndërlidhur me kushtet e veçanta shoqërore si problemet ekonomike të cilat lindin nga niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, këto shoqëri karakterizohen me varfëri në masë të gjerë e cila determinon nivelin e lartë të papunësisë kjo përcillet me rritjen e numrit të popullsisë e cila lindë si pasojë e mosplanifikimit të familjes dhe rritjes së numrit në veçanti industrializimi me evolucionin e tij gjithnjë e më tepër kushtëzon zvogëlimin e numrit të punëtorëve që detyron bartësin e familjes ta detyrojë të migrojnë për të gjetur ambiente më të favorshme për ekzistencë materiale. Këto dukuri determinojnë urbanizim të hovshëm degradimin e familjes erozionin e vlerave etike tradicionale padyshim të ndikuara edhe nga mjetet e informimit publik, angazhimi jo adekuat i organeve sociale dhe pjesëmarrja e tyre në zgjidhjen e problemeve sociale si dhe reformat e

⁵ K., Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, f. 595.

⁶ Ligji për drejtësi për fëmijë, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 148 data: 29.10.2013.

⁷ Z., Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, f. 15.

vonuara arsimore dhe aftësia e tyre për t'u përgjigjur sfidave bashkëkohore.⁸

1.2. Botëkuptimet e ndryshme rreth delikuencës së të miturve

Në dobi të botëkuptimit me pasoja gati të njëjta të aktivitetit kriminal të kryerësit, pa marrë parasysh moshën e tij përcaktimin e nocionit të delikuencës së të miturve bëhet edhe në vështrimin se ajo, sipas karakterit të saj, paraqet të njëjtën lëmi të sjelljeve sikurse edhe ajo e sjelljeve kriminale të personave të rritur. Nocioni “delikuenca e të miturve” në literaturë dhe në legjislacionin e ndryshëm përfshin një panoramë shumë të gjerë të sjelljeve të ndryshme – duke filluar nga papërshtatshmëria deri te delikuenca. Me këtë rast përdoren shumë shpesh nocionet dhe termet jo adekuate dhe të pakapshëm për emërtimin e devijimeve dhe të sjelljeve të ndryshme të rinisë.

Dr. Skaberne dallon termin “delikticiteti i të miturve” nga nocioni “delikuenca e të miturve” duke shtuar se “Termi delikticiteti i të miturve është më i gjerë se sa nocioni delikuenca e të miturve, nga se përfshin jo vetëm delinkuentët e mitur, d.m.th. të miturit me përgjegjësi penale të moshës prej 14-18 vjeçare të cilët kanë kryer veprë penale madje edhe fëmijët deri në moshën 14-vjeçare, të cilët nuk janë përgjigjur për veprë penale, për çka i mituri do të dilte para gjykatës në moshën prej 14 vjetësh e më shumë. Përveç kësaj, në delikticitetin e të miturve numërohen edhe veprimet e tjera negative të fëmijëve dhe të miturve siç janë, për shembull, ikja nga shtëpia, prostitucioni dhe veprimet e tjera të shfrenimit seksual të cilat hyjnë në sanksionet e kodit penal.⁹

Për nevojat e definimit operativ të deliktit të të miturve përdoren argumente të nevojës së përcaktimit “empirik” të nocionit, siç janë: i mituri dhe delikuenca, duke nënkuptuar me fjalën delikuent i mitur personin, i cili ka bërë ndonjë delikt, me ç'rast është e rëndësishme edhe përcaktueshmëria e moshës së kryerësit.

Me përcaktimin e kufirit më të lartë dhe më të ulët të moshës bëhen edhe ndarjet e të miturve nga popullatat e tjera, përkatësisht bëhet dallimi i delinkuentit të mitur nga delinkuenti fëmijë apo i rritur.

Përkundër botëkuptimeve të përmendura, ka mendime se me kupimin sjellje delikte të të rinjve të nënkuptohet sjellja e papërshtatshme, përkatësisht kundër shoqërore e të rinjve, madje qoftë ato forma të

⁸ K., Владо & В., Тајјана, Малолетничка правда, документи на Обединетите Нации - Закон за малолетничка правда со коментари, страна 17.

⁹ L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, f. 20.

sjelljeve, të cilat me ligjet pozitive janë përcaktuar si vepra penale dhe kundërvajtje, qoftë edhe shumë delikte edhe sjellje të tjera, të cilat sipas karakterit të tyre imponojnë zbatimin e masave dhe të aksioneve sociale jashtë-penale, edukuese e të tjera. Me fjalë të tjera, delikuencën e të rinjve e kuptojmë si shprehje e tërësishme e të gjitha sjelljeve të rinjve që nuk janë në pajtim me normat e shkruara dhe të pashkruara të sjelljeve shoqërore (juridike e morale). Kjo praktikisht do të thotë se me fjalën sjellje delikte e të rinjve nënkuptojmë jo vetëm me legjislacionin penal të veprimtarisë së paraparë (si kriminalitet), por, për shembull, edhe papunësinë, ikjen nga shtëpia, ikjen nga shkolla, breddhjen, të fjeturit nëpër skuta, përdorimin e alkoolit, sjelljet e pahijshme në rrugë dhe në vendet e tjera publike, si dhe shumë forma të tjera të sjelljeve të ngjashme të cilat shoqëria si tërësi nuk i lejon.¹⁰

Krahas përcaktimit të nocionit, kuptimi i gjerë “delikuenca e të miturve” shpjegohet me “zgjerimin e kuptimit të delikuencës së të miturve në të gjitha devijimet në sjelljet e njerëzve të rinj siç janë: papërputhshmëria sociale në kuptimin më të gjerë të fjalës, breddhja, pirja e duhanit në shkollë, ikja nga familja dhe shkolla dhe sjelljet e tjera, të cilat shpesh dalin jashtë qarqeve të limitimeve ligjore, si dhe ato aktivitete që janë të inkriminuara me normat e legjislacionit material penal. Ose “delikuenca e të miturve përfshin të gjitha aktivitetet e të miturit që janë të inkriminuara sipas ligjeve pozitive penale të disa vendeve”. Po qe se do të pranoi definicioni se me fjalën delikuencë e të miturve nënkuptojmë sjellje të tilla devijuese të të rinjve, të moshës së caktuar me të cilat do të karakterizoheshin qoftë normat legale dhe aktet përkatëse të institucioneve të caktuara të shoqërisë, qoftë edhe normat morale të mjedisit shoqëror. Përveç kësaj, se definicioni i delikuencës së të miturve në kohë dhe në vende të ndryshme është e llojllojtë, mund të konstatohet se “delikuenca e të miturve si dukuri shoqërore është e pa dëmtueshme e lidhur me shoqëri të caktuara, në të cilat lind”. Përpjekja që të definohet nocioni i delikuencës së të miturve, deri tash kanë mbetur pa sukses. Pjesa më e madhe e legjislacioneve për përcaktimin e kriterëve formale për t’i dalluar të rriturit nga të miturit në procedurën penale janë bazuar në vitet e moshës supozimin e papërgjegjësisë ose në vlerësimet e papërgjegjësisë dhe të kompetencës së organeve për veprim.¹¹

¹⁰ Po aty, f. 20-21.

¹¹ L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, f. 21-22.

1.3. Koncepti material dhe formal i delikuencës së të miturve

Me zgjerimin e nocionit të delikuencës së të miturve me sjelljet e ndryshme asociale të të miturve, të cilat nuk paraqesin vepra penale, pastaj me situatat devijuese dhe me gjendjet që konsiderohen si të dëmshme për zhvillimin e mëtejme të të miturve, krijohet ndarja e nocionit të delikuencës së të miturve prej nocionit të kriminalitetit të të rriturve, i cili bazohet në principet e legalitetit dhe përfshin vetëm veprat penale të kryera nga personat madhorë.

Në rastin e përkrahjes së botëkuptimit se delikuenca e të miturve dhe kriminaliteti i të rriturve paraqesin një dukuri të përbashkët, d.m.th. shkelje të normave penale juridike, atëherë në rastin e përcaktimit të nocionit të delikuencës së të miturve duhet nisur nga ligji penal dhe si delikuenca duhet të trajtohen vetëm ato sjellje të të miturve, të cilat në ligj parashihen si vepra penale. Në këtë mënyrë përmbajtja e delikuencës së të miturve do të përfshinte vetëm ato vepra që paraqesin vepra penale, nëse do të kryheshin nga të rriturit. Kështu si delikuent i mitur do të trajtohej vetëm ai i mitur, i cili krijon tipare të një veprë penale. Ndërkaq, konsiderata e vet momentit formal, d.m.th. e shkeljes së dispozitave ligjore nga i mituri, nuk mjafton për përcaktimin e nocionit të delikuencës së të miturve, sikurse që nuk do të mjaftonte as momenti formal për përcaktimin e veprës penale. Kështu, për shembull me rastin e definimit të nocionit të përgjithshëm të veprës penale është e nevojshme që të merret në konsiderim elementi material, i cili dëshmon thelbin e veprës penale, me çka edhe më shumë është e nevojshme të futen disa elemente që tregojnë kuptimin specifik të vetë veprës, për shkak të një radhe specifikash të personalitetit të mitur dhe sjelljeve të tij në rastin e përcaktimit të nocionit të delikuencës. Në këtë mënyrë arrijmë deri te koncepcioni material e formal të nocionit të delikuencës së të miturve, sipas së cilës realizimi formal i tipizimit të një veprë penale nuk paraqet në vetvete vepër penale, po qe se për shkak të karakterit dhe rëndësisë nuk kërkon intervenimin e bashkësisë. Fakti se një vepër të caktuar penale e ka kryer një person i pa pjekur fizikisht e psikikisht dhe jo i rritur e jo ndonjë i pjekur në aspektin shpirtërorë dhe i rritur, gjithsesi ka rol dominues dhe ndikon në karakterin dhe rëndësinë e veprës. Vepër e tillë penale fiton një karakter tjetër, shpeshherë karakter më të butë, gjë që ndikon edhe në shkallën e rrezikshmërisë shoqërore.

Për shkak të specifikës së personalitetit të të rriturit, dhe të shkallës së rrezikshmërisë shoqërore ka ndryshuar edhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të cilën e kryen ndonjë person i

mitur. Për këtë arsye rrezikshmëria shoqërore si element material nocionin e delikuencës së të miturve e vështron në kuptimin objektiv e subjektiv, me ç'rast potencohet, veçanërisht gjendja e personit të mitur dhe shkalla e rrezikshmërisë së tij shoqërore.

Konceptioni material e formal i delikuencës së të miturve në çfarëdo mase që ky koncepton të përfshijë elementet dhe karakteristikat përkatëse, do të duhej të përmbante në vete specifikat e një lloji të veçantë të kriminalitetit, të cilin e kryejnë personat e moshës së mitur. Kur jemi këtu është me rëndësi të potencohet se konceptioni i tillë ose i ngjashëm nuk do të duhej të ishte pengesë e identifikimit të plotë dhe objektiv të dukurisë së delikuencës së të miturve.¹²

1.3.1. Pozita juridike e fëmijëve dhe përgjegjësia penale e të miturve

Pozita juridike e fëmijëve dhe e të miturve del nga pozita juridike e njeriut dhe e qytetarit në çdo shoqëri. Pozita juridike e njeriut është e kushtëzuar në mënyrë dialektike edhe me pozitën e tij në shoqëri. Shoqëria e organizuar në shtet dispozita të ndryshme juridike rregullon statusin shoqëror e juridik për qytetarët e vet.¹³ Për pozitën shoqërore juridike të fëmijëve dhe të të miturve rëndësi relativisht të madhe kanë edhe dispozitat e një numri të madh ligjesh.

Ndërkaq, krahas rrethanave të përmendura dhe të dhënave të cituara, prej të cilave pjesërisht mund të kuptohet pozita juridike e fëmijëve dhe e të miturve, interesa të veçanta të bashkësisë shoqërore janë gjithashtu në dobi të fëmijëve dhe të të rinjve të pjekurisë së tyre bio-psikike dhe sociale, që tu sigurojë mbrojtje dhe ndihmë, edukim dhe arsimim. E tërë kjo, në mënyrë të domosdoshme kushtëzon që edhe çështja e fëmijëve dhe të miturve dhe e përgjegjësisë së tyre të rregullohet në mënyrë të veçantë. Përgjegjësia e disa kategorive të të rinjve mund të paraqitet në tri forma themelore.

- a) Përgjegjësia disiplinore në shkolla dhe organizata punonjëse.
- b) Përgjegjësia kundërvajtëse.
- c) Përgjegjësia penale juridike.

Çdonjëra prej këtyre formave të përgjegjësisë është rregulluar me dispozita të veçanta. Ndërkaq, shqyrtimet tona të mëtejme do të kenë të bëjnë kryesisht me përgjegjësi penale juridike të të miturve (fëmijëve).¹⁴

¹² L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, f. 32, 33, 34.

¹³ Po aty, f. 37.

¹⁴ L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, f. 44, 45.

1.3.2. Materia juridike që rregullon delinkuentin e të miturve

Në frymën e tendencave bashkëkohore Ligji i ri për fëmijë.¹⁵ i cili në Republikën e Maqedonisë gjen zbatim prej 01.12.2013 dhe i njëjti sipas nenit 19 të ligjit për drejtësi për fëmijë si të mitur e trajton çdo person deri në moshë 18-vjeçare, kurse fëmijë në rrezik e trajton çdo person i cili ka mbushur 7-vjet kurse nuk i ka të mbushur 18-vjet, në vazhdim si kategori e veçantë trajton fëmijët në rrezik i cili ka mbushur 7-vjet kurse nuk i ka të mbushur 14-vjet. Në vazhdim një trajtim i veçantë për fëmijët në rrezik prej moshës 14-18 vjeçare. Fëmijë në përplasje më ligjin për fëmijët prej 14-16 vjeç si dhe fëmijë në përplasje me ligjin të moshës mbi 16-vjeçare.

Posaçërisht për këtë kategori nga aspekti i zbatimit të sanksionit është i paraparë trajtim i posaçëm penalo-juridik, barazuar në atë të fëmijëve i arsyetueshëm nga dy arsye. E para, është e mundur të rriturit më të rinj t'i gjykohet për veprë që e ka kryer si i fëmijë, për shkak të asaj që vepra është zbuluar më vonë ose për shkak të procedurës më të zgjatur. Në këtë rast nuk do të ishte e arsyeshme kryerësit t'i shqiptohet dënim i paraparë për kryes të rritur, sepse dënimi paraqet fajin, kurse pyetja e fajit siç pamë është e zgjedhur në mënyrë të ndryshme kur kemi të bëjmë me vepra të kryera nga fëmija. E dyta, është e mundur po ashtu vepra të jetë e kryer nga personi i rritur i rinj që sipas shkallës së zhvillimit shpirtëror nuk dallon prej atij të të miturit. Edhe në këtë rast do të ishte e pa arsyeshme që kryerësit e tillë t'i shqiptohet dënim për të rritur i cili përsëri paraqet fajin dhe faji-shkallën e pjekurisë që nënkupton aftësinë për kuptimin e rëndësisë së veprës së kryer. Këta janë shkaqet për shkak të së cilave Ligji në fjalë dallon dy situata: shqiptimin e sanksioneve për persona të rritur për vepra të cilat i kanë kryer si të mitur dhe shqiptimin e masave edukuese personave të rritur më të rinj.

Këtë çështje ligji i ri për fëmijë në fuqi e rregullon sipas nenit 69¹⁶ i cili në alinenë e parë parasheh se personi i rritur i cili i ka mbushur 21 vjet nuk mund të gjykohet për veprimet të cilat janë të parapara si vepra penale nëse i ka kryer në periudhën e moshës 14-16 vjeçe, kurse në alinenë e dytë, të po të njëjtut nënë parashihet se personi i rritur i cili i ka mbushur 21 vjet, mund të gjykohet për veprimet të cilat janë të parapara si vepra penale nëse i ka kryer në periudhën e moshës 14-16

¹⁵ Ligji për drejtësi për fëmijë, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 148, data: 29.10.2013, neni 19.

¹⁶ Ligji për drejtësi për fëmijë, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 148, data: 29.10.2013, neni 69.

vjeçe, në qoftë se sipas kodit penal për veprën konkrete është i paraparë dënimi me burg më shumë se 5 vjet.

Sipas ligjit të vjetër të KPM së pari parasheh ndalesë për personin e rritur që ka mbushur 21 vjet të dënohet për vepër penale që e ka kryer si i mitur më i ri. A contrario, prej ndalesës së tillë del se personi i rritur mund të dënohet për çdo vepër që e ka kryer si i mitur më i vjetër.

Edhe sipas ligjit të vjetër, nëse personi i rritur në kohën e gjykimit nuk i ka mbushur 21 vjet mund të gjykohet vetëm për vepra penale për të cilat është paraparë dënim më i rëndë se 5 vjet burg. Bëhet fjalë për vepra që kryerësi i ka kryer si i mitur më i ri në këtë rast kryerësit mund t'i shqiptohet vetëm masë adekuate edukuese e entit. Gjatë vlerësimit a do të shqiptohet masë e tillë gjyqi do t'i merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, posaçërisht të veprës së kryer, koha që ka kaluar prej realizimit të saj, sjelljet e kryerësit edhe qëllimet e masës edukuese.

Personit të rritur i cili e ka kryer veprën penale si i mitur më i vjetër mund t'i shqiptohet masë edukuese adekuate ose dënim për burg më të rritur. Në këtë rast nuk ka rëndësi nëse në kohën që gjykohet kryerësi i rritur nuk i ka plotësuar 21 vjet ose është mbi atë moshë. Gjatë vlerësimit cilin sanksion do ta shqiptojë gjyqi duhet t'i merr parasysh të gjitha rrethanat në raste posaçërisht rëndësinë e veprës, kohën e kaluar prej kryerjes së saj si dhe qëllimi që duhet të arrihet me këtë sanksion. Me përjashtim personit të mitur i cili në kohën e gjykimit i ka mbushur 21 vjet gjyqi mund që në vend të dënimit për të mitur t'i shqiptojë burg ose dënim me kusht. Dënimi me burg i shqiptuar në këtë rast në raport me rehabilitimin shlyerjen e dënimit dhe pasojat juridike nga dënimi, ka të njëjtin veprim juridik si edhe dënimi me burg për të mitur.

Personit të rritur më të ri të cilit mund t'i shqiptohet masë edukuese gjyqi me kushte të parapara me ligj mund t'i shqiptojë të gjitha masat e sigurisë. Masa e shqiptuar edukuese mund të zgjasë më së shumti deri në mbushjen e moshës 21 vjet. Kurse në ligjin e ri për drejtësi për fëmijë, kjo çështje trajtohet në nenin 70¹⁷ me dallim të vetëm tek masa e shqiptuar edukuese e cila mund të zgjasë më së shumti deri në mbushjen e moshës 23 vjeçare,

Me zgjedhjen e tillë ligji shkon në përmbushjen e njoftimeve të verifikuara shkencore për procedimin dhe mos baraspeshimin e zhvillimit të procesit që nuk mund të futet në proceset e vendosura ligjore (nuk e arrin pjekurinë të gjithë me mbushjen e moshës 18 vjet) dhe edhe më

¹⁷ Po aty, neni 70.

pak arsyeton ndërlihdja mbi proceset e tilla në ndarje të holla në trajtimin penalo-juridike!¹⁸

Pozita penalo-juridike e të miturve është vetëm një rrethanë që kushtëzon zbatimin e masave të legjislacionit penal si mjet i fundit në luftimin e delikuencës së të miturve. Legjislacioni penal edhe pse dukshëm e ka rregulluar pozitën penalo juridike e të miturve nuk ka arritur sa duhet të ndikojë në luftimin më të suksesshëm të delikuencës së të miturve. Mirëpo edhe normat penalo juridike më bashkëkohore nuk do të kenë efekte të pritura kriminalo-politike, nëse njëkohësisht nuk bëhen përtëritje përkatëse kadrovike, organizative dhe normative në zbulimin, gjykimin e të miturve dhe ekzekutimin e sanksioneve ndaj tyre.¹⁹

Me rastin e përcaktimit të temës dhe përpunimit të tezave të punimit kam tentuar të bëj një pasqyrim shkencor të nocioneve kryesore të delikuencës së të miturve, rolin e saj në shoqëri, si dhe kontributin e institucioneve shtetërore në parandalimin dhe sanksionimin e këtij fenomeni të rrezikshëm bashkëkohor. Konform kësaj në përputhje me rrethanat e reja të zhvillimit ekonomik-shoqërore bashkëkohor, do të përpiqem të sqaroj fenomenologjinë e delikuencës së të miturve në aspektin shkencorë dhe juridik penal.

2. Aspektet juridike dhe trajtimi institucional i delikuencës së të miturve

2.1. Trajtimi kriminologjik, penologjik dhe sociologjik

Trajtimi kriminologjik - Në kriminologjinë moderne kohëve të fundit delikuenca e të miturve zë gjithnjë e më tepër vend me rendësi dhe mund të thuhet se ajo ditë më ditë paraqet temë të kohës. Problemi parësor i kriminologjisë si shkencë është të gjejë shkaqet e sjelljeve kriminale të të miturve, pra të japë shpjegime etiologjike të delikuencës së të miturve si fenomen i posaçëm. Problem tjetër gjithashtu para së gjithash paraqet edhe ndriçimi i dukurive të ndryshme shoqërore, psikike dhe disa dukuri tjera që janë të lidhura me kriminalitetin. Që të arrije këtë qëllim kriminologjia si shkencë duhet ti analizojë më thellë proceset shoqërore në njërën anë dhe personalitetin e delinkuentit në anën tjetër. Gjatë shqyrtimit të kësaj teme shpesh kemi hasur në shënime që tregojnë jo vetëm për rritjen e këtij lloji të kriminalitetit por edhe për paraqitjen e formave të reja të delikuencës së të miturve. Për deri sa një kategori e autorëve mendojnë se kjo dukuri negative është prodhim

¹⁸ K., Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, f. 614-615.

¹⁹ Z., Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, f. 23.

i mos përmbushjes së nevojave të shoqërisë, kategoria tjetër mendojnë në personalitetin e të miturit. Autor dhe shkolla të ndryshme delikuencës së të miturve i japin rëndësi të madhe veçanërisht “faktorëve kriminogjenë” të cilët ndikojnë në format të ndryshme në paraqitjen e kësaj dukurie negative.²⁰

Sipas studimeve të shumta empirike faktorët që ndikojnë më së shumti në paraqitjen e delikuencës janë të shumta si p.sh.: faktorët ekonomikë, socialë, kulturorë etj. Nocioni: kriminaliteti i të rinjve përdoret për të theksuar aktivitetin kriminal të të gjithë të miturve pa marrë parasysh moshën. Për arsye se ekziston një bindje se e gjithë popullata e re pa marrë parasysh se në çfarë faze gjendet në pikëpamje bio-psikike dhe socio-kulturore ende nuk është formuar dhe se për këtë arsye ende është e nevojshme një qasje dhe trajtim i veçantë. Ky kuptim pak më i gjerë i delikuencës së të miturve më tepër gjen aplikim në trajtimet dhe studimet kriminologjike dhe sociologjike e më pak në ato juridiko-penale sepse sipas konceptcionit juridiko-penal kjo çështje është rregulluar në mënyrë të saktë dhe konkrete më anë të dispozitave penale ku janë përcaktuar moshat dhe kategoritë e caktuara.²¹

Trajtimi Penologjik - Delinkuentët e mitur dallohen jo aq shumë për nga llojet e veprave dhe sjelljeve delikuate por, për nga vetitë e tyre psikike, psikofizike dhe socio-biologjike. Prandaj kjo rrethanë ka rëndësi vendimtare në shqiptimin dhe trajtimin e masave të ndryshme ndaj personave të mitur e në këtë kontekst edhe të masave edukative përmirësuese ndaj tyre. Masat edukative-përmirësuese si sanksione të veçanta penale ndaj të miturve kanë për qëllim në radhë të parë pengimin e veprimit të delinkuentëve të mitur, riedukimin, risocializimin dhe dhënien e ndihmës pas-penale. Duke i zbatuar këto masa, institucionet kompetente që merren me këtë çështje përpiqen që të kenë kujdes dhe mbikëqyrje më të madhe drejt rehabilitimit dhe riedukimit të personave të mitur, të cilët në çfarëdo mënyre kanë manifestuar sjellje dhe veprime të rrezikshme delikuate.²²

Në teorinë penologjike dhe në praktikën ligjdhënëse të shumë shteteve, bëhen përpjekje për gjetjen e masave më adekuate për mbrojtjen e të miturve, për pengimin e veprimtarisë së tyre delikuate dhe për riedukimin dhe risocializimin e tyre. Qëllimi i këtyre përpjekjeve dhe zgjidhjeve konkrete pozitive ligjore në shumë shtete është ofrimi i

²⁰ Z., Ismail, Delikuencia e të miturve në RM, f. 27-28.

²¹ H., Ragip, Kriminologjia, f. 224.

²² Po aty, f. 255.

mbrojtjes dhe ndihmës duke ushtruar mbikëqyrje dhe kontroll ndaj tyre duke i aftësuar ata gjatë qëndrimit nëpër institucione të veçanta dhe duke zhvilluar përgjegjësinë e tyre personale që në të ardhmen të formohen dhe të krijohen si qytetarë të ndershëm dhe korrektë.

Masat edukativo-përmirësuese si sanksione të veçanta penale ndaj të miturve në radhë të parë kanë për qëllim pengimin e veprimit të delinkuentëve të mitur por edhe riedukimin, risocializimin dhe përgatitjen e tyre për jetë. Duke zbatuar këto masa, institucionet e ndryshme në shoqëri përpiqen të kenë një mbikëqyrje dhe kujdes më të madh në drejtim të rehabilitimit dhe riedukimit të personave të mitur të cilët kanë manifestuar sjellje dhe veprime të rrezikshme delikuede.

Teoria-bashkëkohore niset nga koncepti se ndaj të miturve delikuent duhet të aplikohen trajtime të posaçme dhe masa edukuese të cilat i përgjigjen personalitetit të të miturit të cilat janë adekuate nga ana pedagogjike dhe të cilat masa në një mënyrë do të ndikonin në rehabilitimin dhe riedukimin e të miturit delikuent.²³

Në teorinë penologjike dhe në praktikën ligjdhënëse bëhen përpjekje për përgatitjen e masave më adekuate për mbrojtjen e të miturve për pengimin e veprimtarisë së tyre delikuede dhe për riedukimin dhe risocializimin e tyre. Qëllimi i këtyre përpjekjeve dhe zgjidhja konkrete ligjore në shumë shtete, lidhur me këtë çështje është ofrimi, mbrojtja dhe ndihma e personave të mitur delikuent duke ushtruar mbikëqyrje dhe kontroll ndaj tyre, duke i aftësuar ato gjatë qëndrimeve nëpër institucione të veçanta dhe duke zhvilluar përgjegjësinë e tyre personale që në të ardhmen të formohen dhe krijohen si qytetarë të ndershëm dhe korrekt.²⁴

Shikuar në aspektin e ecurisë së numrit të personave të mitur të akuzuar në Republikën e Maqedonisë sipas viteve dhe sipas veprave për të cilat janë akuzuar nga të dhënat statistikore rezultojnë si vijon: në vitin 2005 kanë qenë 889 persona në vitin 2006 kanë qenë 1004 persona të akuzuar. Lidhur me atë se për cilat vepra penale janë akuzuar më së shumti të miturit, nga të dhënat statistikore rezultojnë se numri më i madh i personave të mitur është akuzuar për vepra penale kundër pasurisë: në vitin 2005 gjithsej 1015 persona, në vitin 2006 gjithsej 852 persona. Shikuar nga aspekti se për cilat vepra penale kemi pasur numrin më të vogël të personave të akuzuar për periudhën 2005/ 2006, sipas të dhënave statistikore rezultojnë për këto vepra penale, për veprat penale

²³ Z., Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, f. 30.

²⁴ H., Ragip, Kriminologjia me penologji, f. 421.

kundër mjedisit jetësor gjithsej 3 persona, për veprat penale kundër jurisprudencës 6 persona, për veprat penale kundër forcave të armatosura 1 person, për veprat penale kundër martesës, familjes dhe rinisë 4 persona etj. Shoqëria e brengosur me rritjen e kësaj dukurie negative dhe veçanërisht me rritjen intensive të numrit të të miturve recidivistë, inicion studime gjithëpërfshirëse²⁵ se të trajtimeve të ndryshme të këtij fenomeni shumë të rrezikshëm.

Trajtimi sociologjik - Aspekti sociologjik i sjelljeve socio patologjike dhe sjelljeve tjera të të miturve është i gjerë dhe kohëve të fundit shumë teorik të disiplinave të shkencave humanitare kanë pranuar aspektin sociologjik për këtë dukuri shoqërore. Sipas sociologëve, trajtimi i delikuencës së të miturve i kushtëzuar me një studim shkencor kompleks të cilin gjithsesi duhet adaptuar duke bërë dallimin në kohë të caktuar dhe nëpër mjedise të caktuara. Koncepti kryesor dhe vendimtar në shkollën sociologjike është se faktori dominues në sjelljet e këtilla të të miturve gjendet jo vetëm në faktorin endogjen bio-psikik, por edhe në faktorin shoqëror. Sipas kësaj, rëndësi të posaçme në shfaqjen e veprave penale nga ana e të miturve faktorët e jashtëm veçanërisht faktorët shoqëror dhe rrethanat e tjera në të cilat kryerësi i veprave penale jeton dhe vepron.²⁶

Disa nga faktorët janë: kushtet ekonomike, kushtet e jetës apo siç i quajnë disa autor kushtet banesore, familjare, mungesa e kontrollit të duhur nga ana e prindërve, përfshirja e të miturve në grupe të ndryshme etj. Kjo dukuri e rrezikshme shoqërore sot për shkak të aktualitetit dhe rëndësisë që ka, hyn në kategorinë e problemeve me përmasa botërore. Aspekti sociologjik në të hulumtuarit të sjelljeve të delikuencës së të miturve, duhet të ndryshojë kushtet shoqërore të tyre, me shënime të sakta mbi rrethin familjar, shfrytëzimin e kohës së lirë, konsumimin e alkoolit, substancave narkotike, pjekurinë intelektuale etj. Edhe Hans Von Heting njëri prej teorikëve më eminent në të kuptuarit dhe hetuarit e sjelljeve delikuede, pikëpamjet e veta i ka mbështetur kryesisht në faktorët sociologjik, në të cilët tregon se ato sjellje janë gjithnjë të lidhura me shkaqet sociale dhe konstelacionin e faktorëve individual dhe atyre shoqëror.²⁷

²⁵ Z., Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, f. 31-33.

²⁶ A., Dida, Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, f. 59.

²⁷ Z., Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, f. 21, 22.

The end of the research

To go deeper in the problems that we are treating, the research was determined from the necessity of deductive explanation of crime phenomenon of minors delinquency, without doubt based on respectful and professional bibliography of prominent criminologists domestic and worldwide, concluding that phenomenon of criminality of minors delinquency does not represent a modern phenomenon that is not treated institutionally, but this phenomenon has deep roots and has been manifested at all times of human society but has distinguished itself by form of manifestation and form of social and institutional treatment.

Without doubt, at this point has affected evolution of sociological, psychological, criminological as if penological and legal normative treatment, all of this in the line with circumstances of sociopolitical organizations of this time.

Literatura e shfrytëzuar:

A., Dida, Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, Prishtinë, 1996,
D., Dragomir Davidoviq: Prirucnik za rad na sprecavanju i suzbianju kriminaliteta, Beograd 1968

H. Ragip, Kriminologjia me penologji, Prishtinë, 1995

H. Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2007

H. Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2005,

K., Vllado, E drejta penale pjesa e përgjithshme, "Furkan ISM", Shkup, 2007

Kodi penal i RM-së, Gazeta zyrtare nr.37/96

L., Vesel, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, "Rilindja", Prishtinë, 1982,

Ligji për drejtësi për fëmijë, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 148, data:. 29.10.2013

Ligjit penal për të mitur (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.87/2007)

O. Afrim, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë

S., Ejup Saiti & Z., Ismail-E drejta e procedurës penale e RM-së, UEJL Tetovë, 2007

S., Ismet, E drejta penale për të mitur (me ligjin penal për të mitur), Prishtinë, 2005

S., Zoran, Penologjia, Shkup, 2000

Z., Ismail, Delikuenca e të miturve në RM, Arbëria dizajn, Tetovë, 2008

A., Лупчо & Ц., Виолета, Повторот и повторниците, Скопје, 1989, страна 14